

Crnovrana, komuna e Malishevës/Mališevo, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Pas ngjarjeve në Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze [të shikohen regjistrimet], në muajin mars të vitit 1998, Ruzhdiu aderoi në radhët e UÇK-së. Pjesëtar i njësitit të njëjtë të UÇK-së, ka qenë edhe Habib Berisha, i quajtur Hoxha. Nga dita e premte, më 17.07.1998, që të dy merrnin pjesë në luftimet për çlirimin e **Rahovecit/Orahovac**. Kanë rënë më **25.07.1998**, në vendin e quajtur *Çerdhja e Shqiponjave/Orlovo gnezdo*, në *Bjeshkët e Rahovecit/Orahovačke planine*. Pas dy ditësh, më 27.07.1998, bashkëluftëtarët e tërhoqën trupin e Ruzhdiut nga zona e konflikteve dhe e varrosën në varrezat e Maralisë/Maralija. Një ditë pas rënies së tij, Habibin e varrosën në varrezat në Carravranë/Crnovrana. Pas përfundimit të luftës, në muajin prill të vitit 2000, mbetjet mortore të Ruzhdiut dhe Habibit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Malishevë/Mališevo.

Burimet: deklarata B.X, FDH-33494; SHFEDUÇK, *Feniksët...10*, 98-101, FDH-24474; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Vladan (Dragiša) Mikičević

(22.02.1966, serb nga Prizreni/Prizren, një fëmijë, pjesëtar i UJ-së)

Vladani ka qenë me origjinë nga Kragujevci. Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake në Beograd, drejtimi i artilerisë, e caktuan me detyrë në Prizren. E mbante gradën e kapitenit të klasës së parë. Me bashkëshorten dhe vajzën jetonin përballë kazermës *Dušan Silni*. Nga mesi i korrikut të vitit 1998, Vladani ka marr pjesë në thyerjen e bllokadës përreth Rahovecit/Orahovac. Në datën **25.07.1998**, ai gjendej në kuadër të autokolonës ushtarake që lëvizte në rrugën **Rahovec/Orahovac** – Malishevë/Mališevo. Te vendi i quajtur *Vran Stena*, kolona hasi në një barrikadë. Pjesëtarë të UÇK-së hapën zjarr mbi kolonën ushtarake. Vladanin e qëlluan me një plumb në zemër. Dha shpirt në vend. Dy ditë më vonë, atë e kanë varrosur në varrezat e Kragujevci.

Burimet: deklarata V.M, FDH-27937; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D.300.86, FDH-30601; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 41; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 721; KMKKRF, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.P.320.113, FDH-25579.

Hamzë (Shaban) Mazreku

(17.05.1939, shqiptar nga Optrusha/Opteruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk)

Hamza jetonte te i vëllai Haxhiu me familje. Për shkaqet politike, ai u dënua me dy vjet burgim në vitin 1962. Nga ajo kohë, ai vuan nga paqëndrueshmëria psikike. Kur forcat serbe e sulmuan Optrushën/Opteruša më 18.07.1998, familja e Haxhiut u arratis nga fshati, ndërsa në shtëpi mbetën vetëm Hamza dhe Haxhiu. Pas dhjetë ditësh, më **27.07.1998**, edhe Haxhiu e braktisi fshatin, ndërkaq Hamza mbeti vetëm në shtëpi [**Opterushë/Opteruša**]. Nga ajo ditë, atij i humbet çdo gjurmë. Në regjistrin e të zhdukurve të administruar nga KNKK-ja, lënda e Hamzës e mban numrin BLG-803734-01.

Burimet: deklarata U.M, FDH-13976; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Idriz (Muharrem) Gashi

(1942, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, gjashtë fëmijë)

Në datën **29.07.1998**, nga ora 15:00, forcat serbe nisën sërish me bombardimin e **Drenocit/Drenovac**. Idrizi me bashkëshorten, të birin e vogël dhe të atin e moshëthyer u strehuan në bodrumin e shtëpisë familjare. Për një çast, Idrizi doli që ta rehatonte bagëtinë në ahurin, i cili ndodhej pranë shtëpisë. Në ato çaste, një predhë ra në oborr dhe e qëlloi atë në kraharor. Me ndihmën e dy djelmohave nga Senoci/Sanovac, i ati e barti të birin e plagosur në spitalin e UÇK-së në Senoc/Sanovac, por Idrizi ndërroi jetë pas mesnate. E kanë varrosur në varrezat e Drenocit/Drenovac më 30.07.1998.

Burimet: deklarata B.G, FDH-15489; *Serb Forces Pound Rahovec Villages, Loot Albanian*